



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI**

**Komisioni për Ekonominë dhe Financat**

Tiranë, më 29.01.2019

Dokument parlamentar

*(Komision përgjegjës)*

**R A P O R T**

**PËR PROJEKTLIGJIN**

**“PËR RATIFIKIMIN E LETËRMARRËVESHJES NDRYSHUESE TË  
MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD), PËR  
FINANCIMIN SHITESË TË PROJEKTIT “SIGURIA E DIGAVE”, TË  
RATIFIKUAR ME LIGJIN NR.40/2012”**

***I. Hyrje***

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 29.01.2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin shtesë të projektit “Siguria e digave”, të ratifikuar me ligjin nr.40/2012”, bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator Znj. Evis KUSHI.

Për të mbrojtur projektligjin në emër të Qeverisë, ishin prezent përfaqësues nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

## ***II. Baza ligjore Kushtetuese***

Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave në përputhje me nenet 81, pika 1 e 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 17 të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Ai bazohet në nenet 78, 83 pika 1, dhe 121 pika 1, të Kushtetutës dhe miratimi i tij bëhet me shumicën e gjithë anëtarëve.

## ***III. Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit***

Qëllimi i projektligjit është ratifikimi i letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin shtesë të projektit “Siguria e digave”, të ratifikuar me ligjin nr.40/2012, ligj ky që ka për objektiv: të kontribuojë në mbrojtjen e digave hidroelektrike të kaskadave të lumit Drin dhe Mat në territorin e huamarrësit; të përmirësojë efektivitetin operacional të këtyre digave dhe qëndrueshmërinë e furnizimit me energji në tregun rajonal.

Përmes këtij projektligji në skedulin 2, seksioni IV, shkronja “A2” të marrëveshjes, bëhet një rishpërndarje e fondit në shumën 461 250 euro nga kategoria 4 që është fond i paangazhuar në kategorinë 1, “mallrat dhe punimet”.

Gjithashtu në seksionin IV, shkronja “B.2”, data e mbylljes shtyhet deri më 31 dhjetor 2020.

## ***IV. Shqyrtimi i projektligjit në komision.***

Relatori i Komisionit, në fjalën e tij, shpjegoi se, projektligji vjen pas miratimit në parim të letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas me vendimin e Këshilli të Ministrave nr. 608 datë 17.10.2018, në respektim të nenit 10 të ligjit 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë” .

Ndryshimet e propozuara, nuk prekin thelbin e marrëveshjes së miratuar me ligjin 40/2012 dhe as shtojnë vlerën e huasë e cila mbetet e pandryshuar në masën 15 500 000 Euro, por mundësojnë që në skedulin 2, seksioni IV, shkronja “A2” të bëhet një rishpërndarje e fondit në shumën 461 250 euro nga kategoria 4 që është fond i paangazhuar në kategorinë 1, “mallrat dhe punimet”. Ky rialokim bëhet për shkak se pas demontimeve të tri agregateve/turbinave të para (Ag nr.1-2-3), doli e nevojshme kryerja e punimeve të domosdoshme shtesë të cilat ishin të pamundura të parashikoheshin në kontratë pasi natyra dhe thellësia e punimeve rehabilituese, si dhe planifikimi i aktiviteteve dhe disbursimeve përkatëse varen thellësisht nga niveli i dëmtimit të hidroagregatëve, i cili mësohet vetëm pas demontimit të tyre.

Gjithashtu, për shkak se kryerja e këtyre punimeve shtesë të sipërcituara, kërkon kohë të realizohet, propozohet që në seksionin IV, shkronja “B.2”, data e mbylljes të shtyhet deri më 31 dhjetor 2020.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë e të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, dhanë sqarime të detajuara lidhur me nevojën e kryerjes së këtyre punimeve shtesë dhe pamundësinë e parashikimit të tyre në kontratën fillestare. Për zbatimin e kësaj marrëveshje në tërësi është përgjegjëse Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, si dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Projekti është pjesë e parashikimeve buxhetore të KESH, sh.a., për periudhën 2018-2020.

Anëtarët e komisionit kërkuar të informohen lidhur me situatën aktuale në kaskadën e lumit Drin dhe Mat por edhe në lumenj të tjerë si dhe mbi situatën e import eksportit të energjisë elektrike. Për këtë qëllim nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë u la detyrë sjellja e informacioneve operacionale periodike.

#### **V.      *Ndryshime të projektaktit (nen për nen)***

Pas shqyrtimit të projektligjit, Komisioni për Ekonominë dhe Financat për qëllime të saktësimit të teknikës legislative, vendosi:

- Rregullimi i bazës ligjore në preambulë të bëhet: “Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,”
- Teksti i projektligjit të ndahet në dy nene. Çdo paragraf të jetë nen më vete.
- Në paragrafin e dytë që bëhet neni 2, fjala “vendim” të zëvendësohet me fjalën “ligj”.

#### **VI.    *Përfundime***

Në përfundim Komisioni për Ekonominë dhe Financat, duke evidentuar faktin se kjo marrëveshje është në përputhje me Kushtetutën si dhe legjislacionin në fuqi për marrëveshjet ndërkombëtare si dhe duke vlerësuar se marrëveshja do të mundësojë arritjen e qëllimit për rritjen e sigurisë së digave të hidrocentraleve në kaskadën e lumenjve Drin dhe Mat, përmirësimin e efikasitetit të shfrytëzimit të këtyre digave hidroenergjetike dhe rritjen e sigurisë e cilësisë së furnizimit me energji elektrike, me votat e gjithë anëtarëve të pranishëm e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi.

**RELATOR**

**Evis KUSHI**

**KRYETAR**

**Arben AHMETAJ**